

RAPORTI I VITIT 2017 PËR LIRITË FETARE NË BOTË - MAQEDONIA

Përmbledhje e shkurtër

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe garanton lirinë fetare dhe shprehjen e besimit fetar. Ajo siguron barazi para ligjit për të gjithë individët, pavarësisht nga besimi fetar. Pesë grupet fetare janë përmendur me emër në Kushtetutë; grupet e tjera fetare mund të regjistrohen pranë Qeverisë për përfitime ekuivalente me ato të marra nga pesë grupet e përmendura. Gjykata përgjegjëse për regjistrimin e subjekteve fetare ka pranuar dy aplikime dhe ende nuk ka marrë vendimin për dy të tjera. Në mars, gjykata e dënoi kreun e Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit (KOO), në rigjykimin e tij për shpëlarjen e parave dhe e dënoi me shtatë muaj burg, edhe pse urdhëroi lirimin e tij pas vendimit, duke e llogaritur kohën që kishte kaluar në burg. Gjykata vendosi gjithashtu se qeveria mund të konfiskoje tokën e KOO-së, me vlerë prej 140,000 euro (168,000 dollarë), gjë që qeveria e bëri. KOO-ja edhe më tej nuk arriti të regjistrohet si subjekt fetar. Në nëntor, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) vendosi që qeveria kishte shkelur të drejtat e KOO-së duke refuzuar ta regjistrojë atë dhe urdhëroi qeverinë t'i paguante KOO-së gjobë. Qeveria nuk ua ktheu pronat e konfiskuara më parë grupeve fetare gjatë vitit. Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni (BFI) ka thënë se qeveria ka favorizuar Kishën Ortodokse Maqedonase - Kryepeshkopatën e Ohrit (KOM-KO), ndërsa grupet më të vogla fetare kanë raportuar se qeveria i ka trajtuar në mënyrë të pabarabartë në krahasim me pesë grupet e përmendura në Kushtetutë. Shoqëria civile dhe bashkësitë fetare pakicë kanë deklaruar se qeveria e mëparshme, e cila u largua në qershor, ka politizuar fenë.

Në muajin mars BFI deklaroi pronësinë e plotë të kompleksit ku ishte selia e Bashkësisë Bektashiane të Maqedonisë (Tetovë). Bektashinjtë kanë kundërshtuar planet e BFI-së për të rinovuar kompleksin dhe kanë raportuar ngacmime nga individë të lidhur me BFI-në. Ka pasur raste të gjuhës antisemite në mediat sociale dhe disa individë kanë hedhur fletushka anti-semite në oborrin e zyrave të bashkësisë hebraike. Ka pasur disa incidente të vandalizmit ose vjedhjes së pasurisë së kishave ortodokse, një rast vandalizmi të një varrezë ortodokse dhe një incident të plaçkitjes së një xhamie.

Ambasadori i SHBA-së dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës janë takuar me përfaqësues nga qeveria dhe parlamenti për të diskutuar çështjet e lirisë fetare. Ambasadori është takuar me Ministrin e drejtësisë për të diskutuar projektligjet mbi krimet e urrejtjes, duke përfshirë ato të motivuara nga feja, dhe me kryeministrin, ministrin e punëve të brendshme dhe koordinatorin kundër terrorizmit për të diskutuar tolerancën ndër fetare, rëndësinë e dialogut të hapur dhe partneritet me udhëheqësit fetarë për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm. Ambasadori gjithashtu këto çështje i ka diskutuar me krerët e BFI-së dhe KOM-KO-së dhe me kreun e Kishës Metodiste në Strumicë.

Zyrtarë të ambasadës janë takuar me përfaqësues nga një sërë grupesh të vogla fetare, duke përfshirë edhe grupimet e bektashinjve dhe pakicave të krishtera, si dhe me Komitetin e Helsinkit në vend dhe OJQ-të që merren me lirinë fetare. Ambasada ka mbështetur përpjekjet për edukimin rreth Holokaustit dhe ka sponsorizuar përfaqësues të shoqërisë civile dhe qeverisë për vizita në Shtetet e Bashkuara për programe që në fokus kanë nxitjen e tolerancës fetare. Ambasada gjithashtu ka financuar një seri dokumentare televizive ku janë paraqitur udhëheqës të shquar fetarë, akademikë dhe qytetarë që promovonin tolerancën e bashkësive të ndryshme etnike, gjuhësore dhe fetare.

Pjesa I. Demografia fetare

Qeveria e Shteteve të Bashkuara vlerëson se popullata numëron 2.1 milionë banorë (vlerësim nga muaji korrik 2017). Sipas regjistrimit të fundit shtetëror, të vitit 2002, ka rezultuar se 65% e popullsisë i përket besimit të krishterë ortodoksë, ndërsa 33% myslimanë. Grupet e tjera fetare, që të gjitha së bashku përbëjnë më pak se 2% të popullsisë i përfshijnë katolikët, emërtimet e ndryshme protestante, Dëshmitarët e Jehovahit dhe Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditës së Mëvonshme (Mormonët). Komuniteti hebre vlerëson se ka 200-250 anëtarë. Sipas një sondazhi të prillit nga Brima / Gallup, 1 për qind e popullsisë identifikohet si ateiste.

Shumica e myslimanëve janë sunitë dhe kryesisht jetojnë në pjesët veriore dhe perëndimore të vendit. Shumica e të krishterëve ortodoksë jetojnë në pjesën qendrore dhe juglindore të vendit. Ekziston ndërlidhje mes përkatësisë etnike dhe asaj fetare – shumica e të krishterëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, ndërsa shumica e myslimanëve janë shqiptarë etnikë. Shumica e romëve dhe pothuajse të gjithë turqit dhe boshnjakët janë myslimanë, ndërsa shumica e serbëve dhe vlllehëve janë të krishterë ortodoksë. Ekziston edhe një lidhje midis përkatësisë fetare dhe asaj politike meqenëse partitë politike janë përgjithësisht të ndara në linja etnike.

Pjesa II. Gjendja e respektimit të lirive fetare nga ana e Qeverisë

Korniza ligjore

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe siguron barazinë e të drejtave për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga besimi fetar. Ajo garanton lirinë e fesë dhe të drejtën e individëve për të shprehur besimin e tyre lirisht dhe në publik, në mënyrë individuale ose me të tjerët. Garanton identitetin fetar të bashkësive në vend. Kushtetuta në mënyrë specifike përmend pesë grupe fetare: Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Metodiste Ungjillore dhe Komunitetin Hebre. Ligji mundëson që organizatat e tjera fetare t'i

kenë të drejtat e njëjta dhe statusin ligjor si këto pesë grupe duke aplikuar për njohje nga Qeveria dhe regjistrim përmes gjykatës. Kushtetuta përcakton se pesë grupet fetare të emërtuara dhe “grupet e tjera fetare” janë të ndara nga shteti, të barabarta para ligjit dhe të lira të themelojnë shkolla, bamirësi dhe institucione të tjera shoqërore. Kushtetuta i ndalon partitë politike apo shoqatat e tjera që të nxisin urrejtje ose jotolerancë fetare.

Organizatat fetare mund të kërkojnë të regjistrohen si “kishë”, “bashkësi fetare”, ose “grup fetar”. Këto klasifikime bazohen në madhësinë e grupit, organizimin e brendshëm dhe hierarkinë e brendshme. Sipas autoriteteve gjyqësore, këto tri kategori trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit dhe nuk nënkuptojnë diferencë në të drejtat, përfitimet ose detyrimet ligjore. Qeveria ka njohur 35 organizata fetare (të përbëra nga 17 kisha, nëntë bashkësi fetare dhe nëntë grupe fetare). Pasi të jetë regjistruar, një kishë, një bashkësi fetare ose një grup fetar lirohet nga taksat dhe ka të drejtë të aplikojë për kthimin e pronës të nacionalizuar gjatë epokës komuniste, për projekte të financuara nga qeveria dhe për lejet e ndërtimit për ruajtjen e vendeve të shenjta dhe objekteve të kulturës. Ajo gjithashtu mund të themelojë shkolla. Dështimi i regjistrimit nuk e pengon grupin fetar të mbajë takime ose të predikojë, ose të sjellë dënime ligjore ose gjoba, por e pengon grupin të angazhohet në aktivitete të caktuara, siç janë krijimi i shkollave ose marrja e donacioneve që janë të zbritshme nga tatimi për donatorin.

Gjykata Themelore Shkupi II i pranon aplikimet për regjistrim dhe në afat prej 15 ditë pune duhet të vendosë nëse aplikimi i organizatës fetare i përmbushë kriteret ligjore për regjistrim. Kriteret në fjalë janë: prania fizike administrative në vend; shpjegimi i besimeve dhe praktikave që e dallojnë atë prej organizatave tjera fetare, dhe emri dhe simboli i veçantë zyrtar i grupit. Një organizatë aplikuese duhet gjithashtu të identifikojë një organ mbikëqyrës përgjegjës për menaxhimin e financave të saj dhe të paraqesë kategorizimin e mjeteve financiare të saj dhe burimeve të financimit si dhe procesverbali i kuvendit themelues të organizatës. Ligji e lejon regjistrimin e më tepër grupeve të fesë së njëjtë. Krerët e regjistruar të grupeve fetare ose përfaqësuesit e grupeve fetare duhet të jenë shtetas të vendit.

Gjykata ia dërgon aplikacionet e aprovuara Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR), një organ qeveritar përgjegjës për kultivimin e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet qeverisë dhe grupeve fetare, i cili i regjistron organizatat në Regjistrin e tij. Nëse aplikimi refuzohet nga gjykata, organizata mund të parahtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit. Nëse Gjykata e Apelit hedh poshtë aplikacionin organizata mund të paraqesë kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Gjykatën Kushtetuese, gjykata më lartë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend. Në qoftë se kërkesa refuzohet nga Gjykata Kushtetuese, organizata mund t’i ankohet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).

Ligji nuk i lejon grupet fetare të drejtojnë shkolla fillore private fetare, por e parashikon mundësinë në nivel të shkollimit të mesëm dhe më lartë. Ministria e Arsimit i obligon nxënësit e klasës së gjashtë dhe më lartë ta zgjedhin njërën prej tri lëndëve zgjedhore, dy prej të cilave kanë përmbajtje fetare: Hyrje në religjione dhe Etika në religjion. Sipas përshkrimit të Ministrisë, këto lëndë mbulojnë fenë në mënyrë akademike, jofetare. Lëndët zakonisht ligjërohen nga priftërinj ortodoksë apo imamë, të cilët marrin rrogë nga shteti. Ministria e Arsimit thekson se të gjithë mësimmëndhënësit e këtyre lëndëve marrin trajnim nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë ku ligjërojnë profesorë të filozofisë ose sociologjisë. Nëse nxënësit nuk dëshirojnë të zgjedhin një lëndë mbi fenë, mund të zgjedhin opsionin e tretë, Kulturë klasike e qytetërimit evropian.

Të gjithë të huajt që kërkojnë të hyjnë në vend për të kryer aktivitete fetare ose rite fetare, duhet të marrin vizë pune para mbërritjes, një proces që normalisht zgjat rreth katër muaj. KMBFGR mban një regjistër për të gjithë punonjësit e huaj fetarë dhe e ka autoritetin që t'ua miratojë ose refuzojë të drejtën për të kryer punë fetare brenda vendit. Vizat e punës janë të vlefshme për gjashtë muaj, me mundësi për zgjatje edhe për gjashtë muaj të tjerë. Përtëritja e radhës e vizës është e vlefshme për një vit. Nuk ka kufi për numrin e përtëritjeve të vizave që mund t'i lëshohen një punonjësi fetar. Klerikëve dhe punëtorëve fetarë nga grupe të peregjistruara mund t'u lëshohen viza.

Vendi është palë në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Praktikat qeveritare

Paragraf përmbledhës: Në mars një gjykatë dënoi kryepeshkopin e KOO-së për shpërlarje të parave dhe solli vendim se shteti mund të konfiskojë tokën e KOO-së, gjë që shteti e bëri. GJEDNJ solli vendimin se qeveria ka shkelur të drejtat e KOO duke iu refuzuar regjistrimi dhe i urdhëroi t'i paguajë grupit fetar 9,500 euro (\$11,400). Një gjykatë miratoi regjistrimin e dy grupeve fetare, ndërsa dy aplikacione të tjera mbeten ende pezull. Qeveria gjatë vitit nuk ua ka kthyer pronat grupeve fetare të konfiskuara në të kaluarën. BFI deklaroi se Qeveria ka vazhduar të pengojë ndërtimin e një xhamie në Llazhec, një fshat i përzier etnikisht, si dhe rindërtimin e xhamisë në Prilep. Një institucion parashkollor i peregjistruar u mbyll pasi Qeveria kishte zhvilluar hetime në muajin korrik dhe tha se aty ishin kryer aktivitete fetare të paautorizuara. Një shkollë hoqi ndalimin e mbajtjes së shamive nga nxënësit pas ndërhyrjes nga Avokati i Popullit. Grupet më të vogla fetare thanë se qeveria i ka trajtuar ato në mënyrë të pabarabartë dhe BFI tha se qeveria ka favorizuar KOM-KO-në. Shoqëria civile dhe grupe të vogla fetare deklaruan se qeveria e mëparshme e Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) e ka politizuar fenë dhe ka ndërhyrë në çështjet fetare. Kleri i KOM-KO-së ka marrë pjesë

në ngjarjet politike të VMRO-DPMNE-së, ndërsa BFI-ja ka marrë pjesë në përkrahjen e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) dhe të Lëvizjes Besa.

Sipas profesorëve të ndryshëm universitarë, udhëheqës të organizatave joqeveritare (OJQ) dhe analistëve juridikë dhe politikë, dallimet fetare vazhdojnë të kenë rol në rastet gjyqësore penale dhe civile. Në mars, Gjykata Themelore e Shkupit dënoi kryepeshkopin Jovan Vranishkovski, kreun e KOO-së, për shpërlarje të parave. Gjykata e dënoi Vranishkovskin me shtatë muaj burg dhe liri dy të pandehur të tjerë. Gjykata vendosi gjithashtu se shteti mund të konfiskojë tokën e KOO-së me vlerë prej 140,000 euro (\$168,000), gjë që qeveria e bëri. Gjykata urdhëroi lirimin e Vranishkovskit pasi e kishte dënuar, duke i llogaritur edhe kohën që kishte vuajtur në burg pas një dënimi të mëhershëm për të njëjtën akuzë. Vranishkovski fillimisht ishte dënuar në një rast të shpërlarjes së parave në vitin 2015, por Gjykata Supreme e anuloi dënimin dhe e ktheu çështjen në gjykatën më të ulët për rigjykim. KOO-ja akuzoi qeverinë për paragjytime në këtë rast dhe deklaroi se qeveria e mëparshme kishte urdhëruar gjykatën që "të dënojë Vranishkovskin me çdo kusht", ndërsa avokati i tij paraqiti atë që tha se ishin parregullsi thelbësore dhe procedurale në këtë rast, përfshi mosmarrjen parasysh të rekomandimeve të Gjykatës Supreme për të përcaktuar origjinën e pasurisë dhe parave të fituara, ndërhyrjen politike dhe mungesën e një vendimi me shkrim.

Në një rast tjetër, KOO ka qenë në pritje e sipër të vendimit të GJEDNJ, lidhur me aplikacionin për regjistrim dhe njohje si organizatë fetare, që është refuzuar nga gjykatat në vend mbi bazën e pamundësisë për shpjegimin e dallimit mes emrit dhe simbolit të saj, krahasuar me ato të KOM-KO-së. Më 16 nëntor, GJEDNJ vendosi në favor të KOO, duke deklaruar se, me refuzimin e regjistrimit të KOO (zakonisht e emëruar si "Kisha e Peshkopit të shkarkuar Jovan Vranishkovski") si një grup i veçantë fetar, qeveria ia kishte shkelur KOO-së të drejtën për tubim dhe lirinë e besimit dhe të ndërjegjes. GJEDNJ më tej deklaroi se Qeveria kishte shkelur edhe Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, e cila përfshin një detyrim për të vepruar në mënyrë neutrale dhe të paanshme ndaj grupeve fetare. GJEDNJ urdhëroi qeverinë t'i paguajë KOO-së 4.500 euro (5.400 dollarë) si kompensim dhe 5.000 euro për shpenzimet e gjykatës. Deri në fund të vitit, qeveria nuk kishte paguar asnjë shumë.

Komuniteti Bektashian i Maqedonisë (Tetovë), një urdhër sufist islam, ka vazhduar të presë një vendim nga GJEDNJ-ja lidhur me aplikimin e saj të vitit 2013 me të cilin ka kërkuar nga Gjykata të hedh poshtë refuzimin e Gjykatës Kushtetuese të për t'a regjistruar. Komiteti i Helsinkit ka raportuar se GJEDNJ-ja nuk ka vendosur lidhur me rastin e bektashinjve sepse ka qenë duke shqyrtuar lëndën bashkë me lëndë të tjera të natyrës së ngjashme para se të marrë vendimin. Komuniteti Bektashian ka njoftuar se një zyrtar i GJEDNJ-së i kishte vizituar për të diskutuar rastin gjatë vitit. Qeveria ka vazhduar të lëshojë viza për anëtarët e huaj të

Komunitetit Bektashian të Maqedonisë (Tetovë).

Në maj Gjykata Themelore Shkup II miratoi regjistrimin e Kishës Scientologjike të Maqedonisë dhe të grupit fetar të Shtëpisë së Lutjes. Aplikimet nga bashkësia e krishterë në Maqedoni dhe Bashkësia e Muslimanëve mbetën pezull.

Në gusht, KOO lëshoi një deklaratë duke aluduar në raportin e qeverisë së SHBA për lirinë fetare ndërkombëtare në vend për vitin 2016, duke cituar nga raporti burgosjen e mëparshme të kryepeshkopit Vranishkovski si dhe deklaratën e Komitetit të Helsinkit, se kryepeshkopi ishte një i burgosur politik. Gjithashtu përmendi pjesë të raportit që përmbajnë deklarata nga burime të ndryshme se dallimet fetare kanë pasur ndikim mbi lëndët penale dhe civile të gjykatave dhe se grupet fetare kishin thënë që qeveria ka favorizuar KOM-KO.

Qeveria nuk i ktheu asnjë pronë grupeve fetare gjatë vitit që shteti kishte konfiskuar më parë, ndërsa grupet fetare, duke përfshirë bashkësitë myslimane dhe katolike, raportuan probleme të vazhdueshme me kthimin e pronës. Për shembull, BFI deklaroi se Qeveria kishte kthyer vetëm 15 për qind të pronës që shteti e kishte konfiskuar më parë, dhe ende kërkonte të drejtën e pronësisë mbi Jeni Xhaminë në Manastir, të cilën shteti e ka shpallur monument të kulturës fetare dhe e ka zaptuar në vitin 1950. Kisha Katolike ka vazhduar t'i bëjë thirrje qeverisë të denacionalizojë një pronë të konfiskuar para epokës komuniste në fshatin jugor të Paliurcit, ku donte të ndërtonte një kishë dhe një manastir. Mosmarrëveshja mbi pronën e Paliurcit ka ngecur në gjykata për 10 vjet.

BFI deklaroi se Qeveria ka vazhduar të pengojë ndërtimin e një xhamie në fshatin etnikisht të përzier Lazhec duke mohuar një leje ndërtimi për shkak të presionit nga banorët lokalë të cilët kundërshtojnë ndërtimin e xhamisë. BFI ka njoftuar se Qeveria ka vazhduar gjithashtu të bllokojë rindërtimin e xhamisë në Prilep, e cila u dogj gjatë konfliktit të armatosur në vitin 2001. Sipas BFI-së, qeveria e ka refuzuar lejen për rindërtimin e xhamisë me arsyetimin se objekti në Prilep ka qenë monument i kulturës fetare nën mbrojtjen e shtetit. BFI tha gjithashtu se autoritetet lokale në Kriva Pallankë kanë kundërshtuar ndërtimin e një xhamie atje.

KOM-KO deklaroi se Komuna e Strugës nuk kishte lëshuar një vendim për ndërtimin e një kisha ortodokse në fshatin Belicë dhe se Komuna e Tetovës kishte refuzuar të ndërtonte një rrugë që çonte në kapelën e qytetit. Kërkesa ka qenë në pritje që nga viti 2013.

Në korrik, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale filloi një hetim për një kopsht parashkollor të peregjistruar mysliman. Gjatë inspektimit të parë, ministria ka zbuluar se "edhe fëmijët edhe dy mësuesit kanë konfirmuar se aktivitetet fetare kanë

qenë pjesë e programit të arsimit parashkollor", i cili nuk ishte i lejuar me ligj. BFI dënoi "abuzimin e fëmijëve", dhe tha se do të punojë për të luftuar institucionalisht ato që ai i quajti institucione të paligjshme. Kopshti u mbyll pa ndërhyrje të mëtejshme qeveritare.

Në shtator, Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi, organ këshillimor qeveritar i emëruar nga parlamenti dhe Avokati i Popullit konstatuan se nxënës myslimanë të shkollave fillore në Ohër ishin diskriminuar për besimet dhe veshjet e tyre fetare, pasi u është thënë se nuk mund të merrnin pjesë në mësim me shami në kokë. Pas ndërhyrjes nga Avokati i Popullit, shkolla hoqi ndalimin e shamisë dhe u lejoi nxënësve të ndjekin mësimet.

BFI tha se qeveria ka favorizuar KOM-KO duke i dhënë asaj privilegje unike, siç janë ofrimi i pronave publike pa pagesë, fonde për ndërtimin e kishave të reja ortodokse dhe ftesa ekskluzive për përfaqësuesit e saj për të marrë pjesë në funksionet e qeverisë. KOM-KO mohoi akuzat për favorizim, por tha se një perceptim i tillë mund të ekzistonte, pasi që ishte bashkësia më e madhe fetare në vend. Përveç kësaj, KOM-KO mohoi ndonjë lidhje me qeverinë në largim të VMRO-DPMNE-së dhe deklaroi se nuk përfshihej në politikë.

Organizatat më të vogla fetare që nuk përmenden në Kushtetutë, si Dëshmitarët e Jehovahit, Kisha Ungjillore, Bashkësia Bektashiane (Tetovë), dhe KOO, kanë vazhduar të pohojnë se, Qeveria nuk i trajton ato si të barabartë me pesë organizatat fetare të njohura në Kushtetutë. Për shembull, ata thanë se Qeveria i ka përjashtuar nga ngjarjet zyrtare siç janë shënimet e festave shtetërore dhe ceremonitë e ndryshme përruese, dhe nuk u është dhënë i njëjti nivel i qasjes ndaj zyrtarëve qeveritarë kur kanë kërkuar takime. KOO dhe Bektashinjtë thanë se, si bashkësi të peregjistruara, shpesh janë përballur me diskriminim dhe kërcënime.

Disa grupe të shoqërisë civile, si Komiteti i Helsinkit në vend dhe bashkësitë më të vogla fetare, duke përfshirë Kishën Ungjillore Protestante dhe Bektashinjtë, thanë se qeveria e mëparshme e VMRO-DPMNE-së kishte ndërhyrë në çështjet fetare dhe shpesh ka politizuar fenë. Sipas raportimeve të medias, kleri i KOM-KO mori pjesë në tubimet pro-qeverisë dhe aktivitete tjera politike, duke përfshirë protesta, para formimit të qeverisë së re, e cila mori detyrën më 1 qershor, si dhe në fushatën e VMRO-DPMNE para zgjedhjeve lokale të tetorit. Partitë e tjera politike dhe organizatat e shoqërisë civile thanë se KOM-KO ka shkelur ndalesën e qeverisë për përzierjen e bashkësive fetare në punët e shtetit. Mediat raportuan gjithashtu se BFI ka marrë pjesë në ngjarje në mbështetje të BDI-së, një parti etnike shqiptare dhe, në një masë më të vogël, të Lëvizjes Besa. Raporti i hulumtimit në terren për nivelet e tolerancës fetare, të kryer së bashku nga Instituti ZIP, Qendra maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Civica Mobilitas, përmend abuzimet e diskursit

fetar dhe politizimin e komponentëve fetarë, kryesisht nga KOM-KO dhe BFI. Përveç kësaj, një sondazh i përbashkët i Institutit për Studime Politike Shkup dhe Fondacionit Konrad Adenauer të Gjermanisë arriti në përfundimin se partitë politike, sidomos Lëvizja Besa, kanë përdorur fenë për qëllime politike.

Një mjek mysliman nga Gostivari ka njoftuar se vazhdon t'i nënshtrohet ngacmimit dhe kontrollit të panevojshëm, së fundmi në shtator, nga policia kufitare për shkak të mjekrës së tij të gjatë dhe pantallonave të shkurtra që ai vishte për arsye fetare, me çka janë vonuar kalimet e tij kufitare sa herë që ka hyrë dhe ka dalë nga vendi.

Nga qershori deri në korrik, pas ndërprerjes së memorandumit të mirëkuptimit të qeverisë me Arabinë Saudite, Ministria e Punëve të Jashtme lehtësoi negociatat ndërmjet BFI-së dhe qeverisë saudite për t'u lejuar haxhinjve të marrin viza për të udhëtuar në Haxh.

Gjatë një takimi me kryeministrin Zoran Zaev në korrik, përfaqësuesit e Kishës Katolike shprehën shqetësime rreth vonesave procedurale në marrjen e vizave dhe lejeve të qëndrimit për klerin e huaj.

KMBFGR ka njoftuar se kishte lëshuar pëlqimet për të gjithë misionarët e huaj dhe klerikët të cilët kishin paraqitur kërkesa për punë fetare gjatë vitit.

Pjesa III Gjendja e respektimit shoqëror të lirive fetare

Bektashinjtë kanë vazhduar të njoftojnë policinë për incidente të shqetësimit nga pjesëtarë të BFI-së, të cilët kishin zaptuar kompleksin Harabati Baba Teqe në Tetovë. Në mars, BFI deklaroi pronësinë e plotë të kompleksit, dhe ka njoftuar për planet për rinovimin e tij në partneritet me Agjencinë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim. Përfaqësuesit e Bektashinjve shprehën shqetësime për rinovimin e kompleksit që do t'i zhvendoste ata plotësisht nga kompleksi. Përfaqësuesit e Bektashinjve raportuan se ata dhe vizitorët në kompleks shpesh janë ngacmuar verbalisht dhe u është thënë të largoheshin nga kompleksi. Bektashinjtë nuk mund të pohonin një pretendim pronësie për kompleksin sepse mbetën të paregjistruar.

Ka pasur raste të gjuhës antisemite në mediat sociale. Në një rast, individë kanë deklaruar në mediat sociale se një afarist i shquar amerikan hebre kishte bashkëpunuar me nazistët për shfarosjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në një tjetër, një edicion i janarit i gazetës së përjavshme *Republika* ka përshkruar të njëjtin afarist si një "hebre nazist" në një artikull të titulluar "Luciferi Hyjnor". Në muajin mars, komuniteti hebre raportoi se fletushka me përmbajtje antisemite, përfshirë svastikat dhe fraza "Hebrenjtë Jashtë", u hodhën në oborrin e selisë së tij.

Fondi i Holokaustit i hebrenjve nga Maqedonia, një OJQ, ka vazhduar të punojë me

Ministrinë e Arsimit për të zbatuar programe mësimore të historisë hebraike dhe për të promovuar bashkëpunimin ndërfaqetare. Ky projekt i ka pajisur mësimdhënësit me mjete për t'i mësuar nxënësit e shkollave të mesme rreth historisë së Holokaustit dhe hebrenjve. Qendra përkujtimore e Holokaustit, një muze i mbikëqyrur nga pjesëtarët e bashkësisë hebraike dhe qeverisë që përkujton 7,200 hebrenj të dërguar në kampin e vdekjes së Treblinkës, gjithashtu kanë realizuar programe të edukimit të holokaustit në partneritet me Ministrinë e Arsimit, si dhe kanë organizuar një sërë seminaresh rajonale mbi kulturën hebraike, tolerancën dhe respektin për diversitetin, bashkë me Bullgarinë, Serbinë, Slloveninë, Bosnjë-Hercegovinën dhe Greqinë.

Një sondazh i Brima/Gallup i publikuar në prill zbuloi se 84 për qind e qytetarëve e quanin veten "besimtarë" dhe 10 për qind "jo fetarë". Anketa, e kryer ndërmjet 25 nëntorit dhe 2 dhjetorit 2016, përfshinte 1,210 të anketuar të moshës mbi 15 vjeç.

Ka pasur raporte për vandalizëm në vendet fetare. KOM-KO ka raportuar për akte të vandalizmit të kishave ortodokse, duke përfshirë një përpjekje në shkurt për të djegur derën e një kisha në Saraj. Në shtator, individë kanë goditur me gurë një kishë ortodokse në Çair, dhe vandalët e panjohur plaçkitën një xhami dhe një kishë ortodokse në Strugë. Në janar dhe nëntor, autorët e panjohur vodhën kambanat e kishave ortodokse në Koçan dhe Saraj. Zyrtarët e BFI thanë se nuk dëshironin t'u japin shumë publicitet incidenteve të vogla, në mënyrë që të mos ushqejnë ekstremizëm apo të ftojnë më shumë probleme. Në korrik, autorë të panjohur kanë spërkatur me bojë dhe kanë thyer gurët në varrezat ortodokse në fshatin Luboten të Shkupit. BFI e ka dënuar vandalizmin si "një akt qyqar provokimi" që synonte të cenonte bashkëjetesën.

KOM-KO ka njoftuar për mbi një duzinë plaçkitjesh në kishat në qytete të ndryshme gjatë vitit që kryesisht kanë pasur të bëjnë me paratë e grumbulluara nga donacionet. Policia gjithashtu raportoi një vjedhje të parave në shtator në një xhami në Strugë.

Pjesa IV Politika qeveritare e Shteteve të Bashkuara

Ambasadori i SHBA-së dhe zyrtarët e ambasadës janë takuar me përfaqësues të qeverisë dhe parlamentarëve, duke përfshirë Kryetarin e Parlamentit, për të diskutuar lirinë dhe tolerancën fetare. Në qershor, Ambasadori është takuar me ministrin e atëhershëm të drejtësisë, Bilën Salih, për të diskutuar projektligjet mbi gjuhën e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes, duke përfshirë edhe ato të bazuara në fenë. Ambasadori gjithashtu ka diskutuar për tolerancën ndërfaqetare, rëndësinë e dialogut të hapur dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm me zyrtarë të lartë qeveritarë, duke përfshirë Kryeministrin Zaev, Ministrin e Brendshëm Oliver Spasovski dhe

Koordinatorin e ri kombëtar për përballjen me ekstremizmin e dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, Borçe Petrevski.

Në qershor, ambasadori ka organizuar një iftar me udhëheqës fetarë, përfaqësues të qeverisë lokale dhe qendrore, zyrtarë të angazhuar në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare dhe aktivistëve të shoqërisë civile. Në fjalën e tij Ambasadori ka shprehur mbështetjen e tolerancës fetare dhe lirisë fetare.

Ambasadori dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës janë takuar me krerët e BFI-së dhe KOM-KO për të diskutuar çështje të lirisë fetare, përfshirë akuzat për ndërhyrje politike dhe favorizim ndaj grupeve të caktuara fetare dhe përpjekjet për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm që lidhet me fenë. Në qershor, Ambasadori ka takuar kreun e Kishës Metodiste në Strumicë për të përcjellë një mesazh publik të mbështetjes për tolerancën dhe respektin për diversitetin fetar. Në qershor, një delegacion nga Departamenti i Shtetit dhe zyrtarë të ambasadës janë takuar me kreun e BFI-së Sulejman Rexhepi dhe imamët në Shkup dhe Tetovë për të diskutuar luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm me bazë fetare dhe mënyrat e promovimit të tolerancës fetare. Zyrtarët e ambasadës u takuan me përfaqësues nga bashkësitë më të vogla fetare, si bektashinjtë, ungjillorët e krishterë, mormonët dhe shoqërinë civile, duke përfshirë Komitetin e Helsinkit të vendit dhe OJQ-në Instituti Ballkanik për Besim dhe Kulturë, për të diskutuar mënyrat për të çuar më tej lirinë dhe tolerancën fetare. Këto përfshinin organizimin e një konference rajonale në tetor për të përkujtuar 500 vjetorin e Reformimit Protestant, i cili mblodhi së bashku përfaqësues fetarë, studiues dhe gazetarë.

Në muajin mars, një zyrtar i Departamentit të Shtetit vizitoi Shkupin për takime me ministritë e qeverisë, BFI, KOM, pakicat fetare, akademikë dhe analistë për të diskutuar lirinë fetare në vend. Temat e diskutuara përfshinin çështjet e regjistrimit, kthimin e pronës, edukimin fetar në shkolla, respektin e qeverisë dhe trajtimin e grupeve fetare të pakicave dhe dialogun ndërfaqësor.

Ambasada mbështeti Fondin e Holokaustit të Hebrenjve nga Maqedonia me një grant për të financuar një seminar për mësime të historisë të hebrenjve sefarikë dhe Holokaustin. Dizet e pesë mësime të shkollave fillore dhe të mesme të etnive të ndryshme nga i gjithë vendi dhe rajoni u trajnuan për të mësuar nxënësit e tyre rreth jetës hebraike para luftës dhe Holokaustit, duke përdorur teknologjinë digjitale dhe mediat sociale. Seminari gjithashtu ofroi një mundësi për të ndarë praktikat më të mira për zbatimin e edukimit për Holokaustin në shkolla.

Ambasada ka mbuluar shpenzimet e tre pjesëmarrësve për të marrë pjesë në një akademi ndërkombëtare verore të fokusuar në edukimin rreth Holokaustit, historinë

hebraike të shekullit të 20-të dhe shoqërinë civile, në Budapest dhe Beograd.

Ambasada ka sponsorizuar pjesëmarrjen e shtatë udhëheqësve të bashkësisë dhe shoqërisë civile, përfaqësuesve të qeverisjes lokale dhe një përfaqësuesi nga Ministria e Punëve të Brendshme në një vizitë në Shtetet e Bashkuara në lidhje me projektet që fokusohen në përgjigjet e bazuara në komunitete ndaj ekstremizmit të dhunshëm, duke përfshirë promovimin e tolerancës fetare .

Ambasada ka bashkëpunuar me një ekip gazetarësh dhe profesionistë filmash për të prodhuar dhe transmetuar një seri dokumentare që paraqiste një pasqyrë tolerante dhe multikulturore të bashkësive etnike, gjuhësore dhe fetare të vendit. Shfaqja, *Në të Njëjtën Anë*, përbëhet nga episode 30 minutshe me përmbajtje në të dy gjuhët, maqedonase dhe shqipe. Aty janë paraqitur pjesëtarë të shquar të bashkësive fetare, akademike dhe qytetare nga vende të ndryshme anembanë vendit. Seriali, në sezonin e dytë, u transmetua në Sitel, stacioni televiziv më i madh privat në vend.